REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 12/23
Datë/Datum. 16.01.23
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSh. nr. 12/2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/ L-092, dhe nenin 17 sipas procesverbalit të bordit të OSHP-së, të datës 30.09.2022, për Amandamentim të Rregullores nr.01/2020, me numër të protokollit 83/2022, pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik OE "SKYFTERAT LIVE " SH.P.K Prizren, e datës: 04.01.2023 (protokoll 12/2023), për aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizik i objekteve te KQZ-së" me numër të prokurimit: 320-22-10406-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve , Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj - Mexhuani me datën: 13.01.2023 , mori këtë:

VENDIM

Hedhet si jo e plotë ankesa OE "SKYFTERAT LIVE " SH.P.K Prizren, e datës: 04.01.2023 (protokoll 12/2023), për aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizik i objekteve te KQZ-së" me numër të prokurimit: 320-22-10406-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik të ankesave me datë 04.01.2023, tek rubrika e ankesave ka pranuar një ankesë nga OE "SKYFTERAT LIVE " SH.P.K Prizren, ku kjo ankesë merr numër te protokollit 12/2023, ankesa është parashtruar për aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizik i objekteve te KQZ-së" me numër të prokurimit: 320-22-10406-2-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. E që

sipas verifikimit te kësaj ankese nga zyra e pranimit te ankesave ankuesi për ankesën ne fjalë , nuk ka ofruar dëshminë siç kërkohet me piken 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit e ka njoftuar OE ankues se ankesës së cekur si më lart i ka bashkangjitur formularin për sigurim te depozitës te Ankesës por te njëjtit formular nuk i ka bashkangjitur konfirmimin nga banka si dëshmi se ankuesi ka deponuar mjetet në llogari të OSHP-së si tarifë për ankesën në fjalë, edhe përkundër këtij njoftimi dhe sqarimi te OSHP-së për OE ankues OE "SKYFTERAT LIVE " SH.P.K Prizren nuk e ka kompletuar ankesën e tij me tarifën e depozitës së sigurimit te ankesës në fjalë.
Zyrtarja për të Hyra në OSHP e ka konfirmuar se në llogari të OSHP-së nuk ka mjete te deponuara nga OE "SKYFTERAT LIVE " SH.P.K Prizren, për ankesën me numër te protokollit 12/2023, të datës: 04.01.2023 sipas formularit te Pagesës për Depozite për Sigurim te Ankesës te ofruar nga OE në fjalë.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –
Nga provat e prezantuara vlerësohet se ankesa e parashtruar nga OE "SKYFTERAT LIVE " SH.P.K Prizren, e datës: 04.01.2023 (protokoll 12/2023), për aktivitetin e prokurimit me titull "Sigurimi fizik i objekteve te KQZ-së" me numër të prokurimit: 320-22-10406-2-2-1, iniciuar nga AK Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, konsiderohet si e pa kompletuar sepse ankuesi nuk ka deponuar tarifën e sigurimit të ankesës së tij siç kërkohet në piken 10 paragrafi 1 të nenit 111 të LPP-së lidhur me nenin 118 të LPP-së.
Andaj procedura e shqyrtimit te kësaj ankese përfundon në ketë fazë duke u hedhur si jo e plotë ngase e njëjta nuk plotëson kushtet për tu proceduar më tutje siç kërkohet me nenin 113,114,115,116 dhe 117 të LPP-së.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës kompetente në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryetarja e OSHP-së

Vjosa Gradinaj Mexhuani

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
1x1 OE "SKYFTERAT LIVE " SH.P.K Prizren
1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së